



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

AUDITIMI I PERFORMANCËS

"PERFORMANCA EKONOMIKO FINANCIARE E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE PARASHKOLLORË"

HYRJE; Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 371/3, datë 24.07.2015 realizoi auditimin e performancës me temë "**Performanca ekonomiko – financiare e strukturave përgjegjëse për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve parashkollorë**". Ky auditim u programua për t'u ushtruar në QEZHEF Tiranë, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Kukës, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Vlorë. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 371/4, datë 26.11.2015 u dërgua projekt-raporti i auditimit në QEZHEF Tiranë dhe Bashkinë Tiranë, Kukës, Elbasan, Fier dhe Bashkinë Vlorë. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysht të dhënat sipas pyetësorëve shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raport Auditimit.

KONKLUDOI; Në politikat e mbrojtjes shoqërore të një vendi, vend të rëndësishëm zë mbrojtja dhe ngritja e një sistemi sa më cilësor të shërbimeve ndaj fëmijëve dhe shtrirjes së tyre pranë kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

...Me qëllim zhvillimin e plotë dhe harmonik të personalitetit të vet, fëmija duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi...

hyrje në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve

Të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të fëmijëve duhet të mbrohen me përparësi nga çdo individ, familje dhe institucion, sepse kemi të bëjmë jo vetëm me qenie njerëzore përgjithësisht të pambrojtura, por edhe se niveli i sotëm i zhvillimit të tyre fizik e mendor, do të përcaktojë gjithsesi të nesërmen e të ardhmen e vendit tonë.

Nëpërmjet këtij auditimi ne jemi përpjekur e dëshirojmë të skicojmë e adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithpërfshirëse për këtë shërbim kaq të rëndësishëm për rritjen e fëmijëve. Gjithashtu duke vepruar në emër të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve për edukim dhe zhvillim të përgjithshëm, kërkojmë të reflektojmë dhe promovojmë konsensusin ndërmjet profesionistëve të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve parashkollorë, pushtetit vendor dhe qeverisjes qendrore, shoqërisë civile, grupeve të interesuara, komunitetit të prindërve dhe publikut të gjerë, se rritja e performancës së këtij shërbimi, është investimi për trasenë që po shtojmë drejt BE dhe ndikon thelbësisht zhvillimin tërësor të vendit.

KLSH ka ndërmarrë këtë auditim dhe është përqendruar në rezultate dhe proces, duke theksuar nevojën për ndryshim, përmirësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm të menaxhimit, gjithashtu me anë të tij kemi vëmë në pah anët pozitive dhe negative të këtij menaxhimi kompleks për nga politikat, drejtimi dhe vartësia.

Ofrimi i një shërbimi sa më të mirë, nisur nga shqetësimi në lidhje me: hartimin e politikave dhe strategjive mbi trajtimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte; shtimit të kapacitete dhe hapjes së ambjenteve të reja; pengesat në menaxhim si pasojë e ndërvarësive institucionale; mungesa të fondeve dhe çelja e tyre me vonese; mënyrës së funksionimit të këtij shërbimit; pagat e ulta të ekipit edukator dhe ndihmës që merret me trajtimin e fëmijëve; trajtimi i fëmijëve në mënyrë të barabartë; luftës kundër korrupsionit; etj.;

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj fëmijëve në çerdhe e kopshteve është domosdoshmëri e cila mund të arrihet maksimalisht ndërmjet shtimit dhe menaxhimit më të mirë të fondeve nga pushteti vendor e qendror të cilat kanë si qëllim; transformimin e infrastrukturës; rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve të reja; rritjen e cilësisë së ushqimit; trajtimin e fëmijëve nga ekipi edukator dhe mjekësor; çka do të sillte një impakt pozitiv në investimin e kryer për të ardhmen e brezit që rritet në shërbim të vendit.

Çerdhet dhe kopshtet zënë një vend të rëndësishëm në formimin harmonik të personalitetit të fëmijëve, nëpërmjet edukimit dhe formimit të tyre si individë të lirë, të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës në jetën shoqërore. Prindërit presin që institucionet e shërbimit parashkollor të ofrojnë mbi të gjitha një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për fëmijët e tyre. Pra, çerdhet dhe kopshtet përveç se të edukojnë fëmijën, duhet të garantojnë që ata të jenë të sigurt dhe të mbrojtur. Një rëndësi të veçantë në pritshmërinë e prindërve, ka edhe plotësimi i nevojave ushqimore të fëmijëve nëpërmjet sigurimit të ushqimit të përshtatshëm, i cili stimulon mirërritjen e tyre fizike, sociale dhe mendore.

Auditimi ka patur në qendër të vëmendjes, problematikën aktuale dhe instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën, gjithashtu pasqyrimin me realizëm dhe objektivitet të situatës, identifikim i nevojave për shërbimin e afruar në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve, mbrojtjen e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të lidhura me këtë shërbim.

Mesazhi kryesor i këtij auditimi është: *“Pushteti vendor në bashkëpunim me Qeverinë, të nxisë një plani veprimi në unifikimin dhe përmirësimin e performancës së menaxhimit të shërbimit në çerdhe e kopshte me synim përfundimin e një qasjeje të re në shërbim të fëmijës dhe personalitetit të tij, sepse_kjo çështje na prek të gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve”*.

Në mënyrë të detajuar të gjitha mangësitë janë trajtuar hollësisht në këtë Raport Auditimi rast pas rasti, si gjetje konkrete me konkluzionet përkatëse.

Disa nga konkluzionet e këtij auditimi sipas gjetjeve në mënyrë të përmbledhur janë;

- ✓ Mos-njohja, përshtatja dhe analizimi i funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së qendrave administrative të cilat merren me rritjen dhe edukimin e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç në përputhje me legjislacionin tyre në mënyrë të detajuar e të hollësishme bën që të humbi besimi dhe efikasiteti i shërbimit, sepse standardet rrisin besimin në cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimit, ato ulin kostot. Gjithashtu përshtatja e legjislacionit ka efekte pozitive në: komunikimin ndërmjet sektorëve; sigurojnë nivele të ulëta të problematikave e mos marrëveshjeve; rrisin besueshmërinë në sigurinë e shërbimit; ndikojnë në sistemet e drejtimit; ndikojnë në sistemet e cilësisë; etj.

- ✓ Me ndërtimin dhe infrastrukturën është i lidhur çdo element sepse ato kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin fizik, social dhe psikologjik të fëmijës, gjithashtu përshtatja e infrastrukturës ka të bëjë me kujdesin ndaj tyre, është e lidhur me sigurinë fizike, higjienën dhe mbarëvajtjen e shëndetit, si standarde minimale të kujdesit.
 - ✓ Vendosja e kabinave dhe shtyllave të tensionit të lartë në oborret e çerdheve dhe të kopshteve përbën rrezik për jetën e fëmijëve dhe personelit që punon në to si dhe efektet rrezatuese të tyre janë të dëmshme për shëndetin e tyre në të ardhmen e nuk shfaqen menjëherë.
 - ✓ Duke mos patur punonjës të arsimuar dhe të kualifikuar nuk plotësohet me cilësi veprimtaria shoqërisht e dobishme e rritjes së fëmijëve. Arsimimi në një fushë të caktuar i ndihmon njerëzit të specializohen në atë fushë dhe të bëhen zot të profesionit të tyre dhe për të qenë konkurrues në tregun e punës.
 - ✓ Kriteret dhe standardet janë të domosdoshme në përzgjedhjen e edukatoreve që merren me rritjen e fëmijës sepse janë ato që punojnë direkt me fëmijën, krijojnë sigurinë fizike, psikologjike, emocionale për ta, janë ato që do të përdorin një shumëllojshmëri mënyrash e teknikash për mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin e një fëmije.
 - ✓ Vlerësimi shumë i ulët për nga vlera monetare (paga) bën që motivimi i edukatoreve të fëmijëve në çerdhe të mos jetë në lartësinë e duhur kur ky profesion është shumë i rëndësishëm sepse ka në dorë një pjesë nga koha e rritjes dhe formimi të fëmijëve.
 - ✓ Studim mbi koston e shërbimit që ofrohet në çerdhe dhe kopshte është e domosdoshme dhe bazë për të garantuar një ecuri të qëndrueshme e sa më afatgjatë të tij, ai nuk ka për qëllimin vetëm të përlllogarisë përfitimet ekonomike dhe sociale nga përmirësimet cilësore në çerdhe dhe kopshte por tregon se si investime në faktorë cilësorë kanë bene fite afatgjata për fëmijën, familjen dhe shoqërinë.
 - ✓ Një meny sa më e mirë ushqimore për fëmijët e vegjël është e një rëndësie të veçantë sepse përzgjidhen, vlerat ushqyese të ushqimeve për tu konsumuar dhe sasia e tyre në proporcion të drejtë, duke ndërtuar një meny të shëndetshme u jepen fëmijëve kaloritë që duhet.
 - ✓ Uji është përbërësi më i madh i trupit të njeriut, është thelbësor për një mënyrë jetese të shëndetshme. Mos marrja e ujit në cilësinë dhe sasinë e duhur ul aftësitë e trupit të njeriut për të luftuar sëmundje dhe funksionimit me normalitet, një kombinim i ujit të pijshëm, lëngjeve, dhe ushqimit është përcaktues për të parandaluar efektet e dëmshme.
 - ✓ Studimi për tarifën e pagesës së shërbimit që ofrohet në çerdhe dhe kopshte është i domosdoshëm sepse mbi këtë bazë, llogariten kilokaloritë që duhet të marrë një fëmijë sipas llojeve, sasisë e cilësisë së produkteve ushqimore që do tu shërbehen.
 - ✓ Mungesa e shpjegime në VKB të Bashkisë Tiranës për tarifën fikse, si llogaritjet, sa është vlera e saj dhe nga kush paguhet, mund të jetë me pasoja sepse mund të përbëjë një të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë (detyrimi mujor përbëhet nga tarifa fikse dhe tarifa për ushqimin).
 - ✓ Fondet e pamjaftueshme sjellin mangësi në përkujdesjen, rritjen e mirëqenies së fëmijëve, edukimin dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm.
 - ✓ Çelja në kohë e fondeve sjell kryerjen me rregull të procedurave të prokurimit të cilat sjellin të ardhura sepse ka koordinim të mirë ndërmjet, legjislacionit dhe rregulloreve; fazave operacionale dhe menaxhimit të tenderave; sistemeve të kontrollit dhe monitorimit.
- Të gjitha këto sfida dhe problematika në administrimin e çerdheve dhe kopshteve nuk garantojnë plotësisht plotësimin e indikatorëve të performancës në përputhje me parimet

e eficensës në mirërritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm psikoemocional të fëmijëve në vitet e para të jetës, ndaj kërkohet zgjidhje konkrete dhe ndërhyrje efikase

Disa nga mangësitë e konstatuara gjatë këtij auditimi në mënyrë të përmbledhur janë në drejtim të;

- × Legjislacioni që rregullon marrëdhëniet e këtij shërbimi është i shumë viteve më parë, duke mos u përshtatur me situatën aktuale në të cilën ndodhemi dhe mos marrë në konsideratë praktikën përvojat dhe standardet e BE në të cilën ne përpiqemi të integrohemi dhe në këtë fushë;
- × Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 32, datë 01.07.2004 për miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”; nuk është në përputhje me këtë legjislacion si dhe me realitetin që është në çerdhet e kopshtet e qytetit; nuk është i përputhur me strukturën dhe detyrat që realisht kryhen në këtë qendër si dhe përshtatur me standardet si të përcaktuar në këtë legjislacion por dhe me atë të BE.
- × nevojat për ndërtimin e çerdheve e kopshteve të reja janë urgjente; çerdhet dhe kopshtet janë mbi kapacitetet e tyre;
- × në oborret e çerdheve e kopshteve të qytetit të Tiranës janë ndërtuar shtylla dhe kabina elektrike të tensionit të lartë të cilat përbëjnë rrezik për jetën dhe shëndetin e fëmijëve e të punonjësve që merren me mirërritjen e tyre.
- × nuk ka strategji për identifikimin, inkurajimin, matjen, vlerësimin, promovimin dhe shpërblimin e performancës së punonjësit;
- × janë evidentuar raste të drejtuesve në çerdhe, personelit që merret me rritjen e fëmijëve dhe personelit ndihmës të jenë me arsim jo në përshtatje me pozicion dhe me punën që bëjnë;
- × shkalla e arsimimit të punonjësve të administratës nuk është e njëjtë me pozicionin e punës ku vlen të theksohet se Drejtori i Financës në këtë qendër që ka drejtuar financiarisht këtë institucion ka patur arsimin e lartë për zooteknikë-veterinari;
- × nuk ka kriteret apo standarde të përcaktuara për zgjedhjen e stafit, punonjësve që do të merret direkt me rritjen dhe edukimin e fëmijëve;
- × paga e një edukatoreje në çerdhe ka një diferencë të theksuar me pagën e një edukatoreje kopshti, për një punë pothuajse të njëjtë që bëjnë;
- × paga e administratës që merret me administrimin e çerdheve ka një diferencë të theksuar me pagën e administratës që merret me administrimin e kopshteve, për punë të njëjtë që bëjnë;
- × në të gjitha Bashkitë nuk ka studime për koston e shërbimit që ofrohet në çerdhet dhe kopshtet;
- × në të gjitha Bashkitë nuk ka studime të mirëfillta dhe të dokumentuara të organizuara nga grupe mjekësh e dietologësh për ushqyerjen sa më cilësore të fëmijëve në çerdhe e kopshte, kështu menyuja e ushqimit është në dorën e mjekut të QEZHEF apo dhe mjekëve të tjerë nëpër bashki, praktikë që e lë menynë në dorën e një mjeku dhe jo të studimeve e konsultave me grupe specialistësh të disa fushave;
- × menyuja e ushqimit ka ndryshuar disa herë si në rastet, ku ndryshimet kanë qenë jothelbësore, të pastuduara, madje mund të thuhet sa për të vënë emrin e Ministrit në këtë ndryshim;
- × menytë në të gjitha rastet përcaktohen se janë **orientuese**, çka mund të krijojë mundësi punonjësve në çerdhe e kopshte ose në administratë të “ndryshojë” sipas eksperiencave apo të lihet spontanitetit;
- × uji i pijshëm në çerdhe dhe kopshte nuk përfshihet në meny, ai silllet nga prindërit për fëmijët e tyre, nuk ka siguri në përdorimin e tij si ujë i pijshëm për fëmijët e vegjël;

- ✗ në të gjitha Bashkitë nuk ka studime edhe për tarifën e shërbimit që ofrohet në çerdhet dhe kopshtet;
- ✗ nuk ka një qëndrim për shërbimin e ofruar në çerdhe dhe kopshte nga të gjitha Bashkitë, si në mënyrën e përcaktimit të tarifës së shërbimit ashtu dhe në përcaktimin e vlerës së saj;
- ✗ qendrat ekonomike të cilat merren me administrimin e veprimtarisë së çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë së qytetit, disponojnë fonde të pamjaftueshme për zhvillimin dhe realizimin e misionit të tyre, kanë vonesa në çeljen e fondeve si dhe shkëputje ndërmjet ndërmarrjeve të Bashkive që administrojnë fondet e riparimeve dhe ndërtimeve me këto qendrat ekonomike të cilat ndjekin realisht problemet që ekzistojnë në çerdhet dhe kopshte e qytetit të tyre.
- ✗ në çerdhet dhe kopshte megjithëse është bërë punë e mirë përsëri nuk ka mjaftueshëm ose nuk ka aspak hapësirë për lojëra në ambient të hapur (oborre), në disa raste ekspozohen ndaj rreziqeve që vijnë nga ndërtimi, oborri është ngjitur me rrugët kryesore, oborri përdoret në disa raste si vend parkimi, nuk ka investime për ti kthyer në vend argëtimi për fëmijët;
- ✗ ka nevoja emergjente për riparime sepse ato nuk janë realizuar në të mirën e mundshme dhe lagështira është prezent në disa prej tyre;
- ✗ kopshtet vazhdojnë të kenë vartësi të dyfishtë, mënyrë organizimi e cila bën që kopshtet të kenë mangësi në performancën më të mirë të zhvillimit të aktivitetit të tyre;
- ✗ bashkëpunimi i QEZHEF me Drejtorinë nr.3, të Punëtorëve të Qytetit në pothuajse shumicë e rasteve nuk ka qenë në efikasitetin e duhur, në shërbimet e mirëmbajtjes infrastrukturës godinave të çerdheve si, meremetime, lysterje, dezinfektim, izolime të lagështirës, shërbime elektrike e hidraulike dhe riparimet e funksionimit të sistemeve të ngrohjes;
- ✗ nuk ka patur rritjen e numrit të fëmijëve që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet nga viti në vit ose ajo ka qenë në numër shumë të vogël;
- ✗ në raportin edukatore – fëmijë në kopshte, situata paraqitet e përkeqësuar e cila vazhdon të mos korrigjohet kjo për faktin se nuk ka rritje të numrit të tyre;
- ✗ furnizimi i çerdheve dhe kopshteve me ushqime, bëhet me automjete të papërshtatshme për ketë shërbim dhe tejet të amortizuara;

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi **Kryetari** i KLSH-së:

M I R A T O I:
me
V E N D I M
Nr.170, Datë 28/12/2015

I. Raportin e Auditimit me temë “Performanca ekonomiko – financiare e strukturave përgjegjëse për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve parashkollorë”, të ushtruar në QEZHEF Tiranë, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Kukës, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Vlorë.

II. Rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

1.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë, Qeverinë, grupet e interesit të marrin masa për përshtatjen e

legjislacionit të tyre në përputhje me kushtet realitetin, përvojat me të mira si dhe standardet e BE.

Menjëherë

2.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë e qytetit të tyre dhe Qeverinë të marrin masa për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve të reja kjo dhe në përputhje me kushtet dhe standardet e BE.

Vazhdimisht

3.

- ✓ QEZHEF Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të marrë masa për heqjen e shtyllës së tensionit të lartë në çerdhen dhe kopshtin Shkozë e re si dhe kabinave elektrike të tensionit të lartë nga oborret e çerdheve dhe kopshteve. Gjithashtu për abuzuesit e vendosjes së tyre jo konform ligjit të ndiqen të gjitha hapat ligjore në penalizmin e tyre.

Menjëherë

4.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë, grupet e interesit të hartojnë strategji për identifikimin, inkurajimin, matjen, vlerësimin, provimin dhe shpërblimin e performancës së punonjësit si dhe hartojnë kriteret dhe standardet e domosdoshme në përzgjedhjen e tyre në punë.

Menjëherë

5.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë dhe Qeverinë ti rrisin dhe ti njehsojnë pagat e personelit të çerdheve (përgjegjëse, edukatore, kuzhinierëve, personel ndihmës etj.), me pagat e personelit të kopshteve (përgjegjëse, edukatore, kuzhinierëve, personel ndihmës etj.), gjithashtu dhe të administratës së tyre.

Menjëherë

6.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë, të hartojnë kostot e shërbimit të ofruar në çerdhe dhe kopshte për të garantuar një ecuri të qëndrueshme e sa më afatgjatë.

Vazhdimisht

7.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë, Ministrinë e Shëndetësisë, grupet e interesit të hartojnë meny shkencore, bashkëkohore dhe në zbatim të udhëzimeve apo studimeve të OBSH e praktikave më të mira, për mirë ushqyerjen e fëmijëve të vegjël sipas grup moshave.

Vazhdimisht

8.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë, Ministrinë e Shëndetësisë, ti japin zgjidhje problemit të përdorimit të ujit të pijshëm tek fëmijët, problemit të ndotjes bakteriologjike si për ujin që

vjen nga rrjeti ashtu dhe ujit që përdoret nga depozitave e instaluar në çerdhe e kopshte si dhe të monitorohet pirja e ujit të pijshëm tek çdo fëmijë.

Vazhdimisht

9.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, në bashkëpunim me Bashkitë, grupet e interesit të studiojnë dhe përcaktojnë tarifën e pagesës për këtë shërbim në përputhje me menytë, duke mundësuar shmangien nga praktika ku tarifa përcakton menytë.

Menjëherë

10.

- ✓ QZHEF Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës ti japë zgjidhje përcaktimit të saktë të tarifës fikse, si pjesë e detyrimit mujor. (detyrimi mujor përbëhet nga tarifa fikse dhe tarifa për ushqimin)

Menjëherë

11.

- ✓ Qendrat Ekonomike që merren me administrimin e çerdheve dhe kopshteve, të ushtrojnë presion të vazhdueshëm ndaj Bashkive të qyteteve të tyre, për rritjen e fondeve buxhetore, për përmbushjen misionit dhe qëllimit të tyre në rritjen e mirëqenies së fëmijëve.

Vazhdimisht

12.

- ✓ Qendrat Ekonomike në bashkëpunim me Bashkitë e qyteteve të marrin masa për përmirësimin e hapësirave të lojërave në ambient të hapur (oborre); eliminimin e lagështirës dhe marrjen e masave për kryerjen e punimeve me cilësi; përmirësimin e raportit edukator fëmijë; blerjes së automjeteve të reja në përputhje me standardet që duhet të plotësojë një mjet që transporton ushqime në shërbim të fëmijëve.

Vazhdimisht

13.

- ✓ QZHEF Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë ti japë zgjidhje mënyrës së organizimit të shërbimit të mirëmbajtjes në çerdhe dhe kopshte.

Menjëherë

14.

- ✓ QZHEF Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Arsimit e Sporteve ti japin zgjidhje ndërvarësisë së dyfishtë të veprimtarisë së kopshteve të qytetit të Tiranës duke kaluar në vartësi të vetëm një drejtorie.

Menjëherë

Grupi i Auditimit

Rinald **Muça**

Alfred **Zylfi**

Elfrida **Agolli**

Drejtori Departamentit Auditimit të Performancës
Rinald **Muça**

Bujar LESKAJ

KRYETAR

Tiranë, Dhjetor 2015